



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:015778

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06635359

P.nr.330/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi Muqaj, në çështjen penale, kundër të pandehurve M.L, H.L, M.G dhe J.G të akuzuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.131/2023, të datës 27.02.2023, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 11.12.2024, në të cilin kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, i dëmtuari A.M si dhe të pandehurit M.L, H.L, M.G dhe J.G, me datë 12.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.12.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

M.L, i lindur me dt....., në, ndërsa tani me banim në fshatin, në komunën e Klinës, i biri i A. dhe nënës GJ., e vajzërisë, punëtor në ndërtimtari, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, posedon telefon me numër, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

H.L., i lindur me datë, në, ndërsa tani me banim në fshatin, në rr. “.....”, në Komunën e Klinës, i biri i A. dhe nënës Gj., e vajzërisë, punëtor, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me

numër personal, posedon telefon me numër, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

M.G., i lindur me datë, në, ndërsa tani me banim në fsh. në Komunën e Klinës, i biri i A., dhe nënës Z., e vajzërisë, me profesion fasader, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, posedon telefon me numër, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

J.G., i lindur me dt....., në, ndërsa tani me banim në fsh. rr., K. Klinë, i biri i R., dhe nënës R2., e vajzërisë, me profesion punëtor, ka të kryer 7 klasë të shkollës fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër, posedon telefon me numër, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri.**

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën 16.01.2023, rreth orës 19:00 minuta, në fsh Dollc K. Klinë, në bashkëkryerje dhe me dashje përdorin forcën ndaj personit tjetër dhe atë të dëmtuarit A.M, në atë mënyrën që, të pandehurit fillimisht e thërrasin në telefon të dëmtuarin, ku me të njëjtin dakordohen që të takohen në rrugën e fshatit Dollc për të biseduar, me të arritur i dëmtuari në hyrje të rrugës së fshatit, afër tij ndalon një veturë (pikap), brenda së cilës ishin të pandehurit, të cilët e hapin derën dhe kërkojnë nga i dëmtuari që të futet brenda në veturë, e posa i dëmtuari hyn në veturë, të pandehurit vazhdojnë rrugën e fshatit, e pasi arrijnë në fund të rrugës së fshatit, në një vend pothuajse të pabanuar, zbresin nga vetura, e posa i dëmtuari zbret, fillimisht i pandehuri M. i cili e godet të dëmtuarin me shuplaka në fytyrë dhe kokë, ndërsa i pandehuri M2. e incizon ngjarjen me telefonin e tij, e pasi i njëjti e ndërprente incizimin, më pas të gjithë të pandehurit e godasin me shuplaka të dëmtuarin, e pasi të pandehurit përfundojnë me rrahje, më pas e urdhërojnë sërish të dëmtuarin të hynë në veturë, të cilin edhe e kthejnë në vendin ku e kanë marr,

- Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale **“Sulmi”** nga neni 184 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72, 79 dhe 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe neneve 240, 241 paragrafi 1, 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 24, 242 paragrafi 6, 364, 449 par. 1 dhe 2 dhe nën paragrafi 2.6, 450, 452 par. 1 dhe 462 par. 2 të KPRK-së, të pandehurit:

I G J Y K O N

- I. Të pandehurin **M.L**, me **DËNIM ME GJOBË**, në shumën prej njëmijë (1000) euro, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim policor prej dyzetetë (48) orësh, duke filluar nga dt. 17.01.2023 deri me 19.01.2023, ku një ditë e ndalimit i llogaritet në shumën prej njëzetë (20) euro, saktësisht shuma prej dyzetë (40) euro, me çrast i njëjti obligohet që të paguajë shumën prej shtatëqind e gjashtëdhjetë (960) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguajë brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Ndërsa të pandehurit **H.L, M.G dhe J.G**, secilin veç e veç me **DËNIM ME GJOBË**, në shumën prej tetëqind (800) euro, në të cilin dënim iu llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim policor prej dyzetetë (48) orësh, duke filluar nga dt. 17.01.2023 deri me 19.01.2023, ku një ditë e ndalimit i llogaritet në shumën prej njëzetë (20) euro, saktësisht shuma prej dyzetë (40) euro për secilin, me çrast të njëjtit obligohen që veç e veç të paguajnë shumën prej shtatëqind e gjashtëdhjetë (760) euro, të cilin dënim të pandehurit obligohen të e paguajnë brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse të pandehurit, nuk dëshirojnë ose nuk mund të e paguajnë gjobën e cekuar si më lartë brenda afatit të lartcekur, gjykata do të e zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku njëzetë (20) euro gjobë, do ti llogariten barabartë me një (1) ditë burgimi.
- IV. Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën në tërësi, gjykata do të e zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës në dënim me burgim. Nëse të pandehurit e paguajnë pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

V. Obligohen të pandehurit secili veç e veç, që gjykatës të ia paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

VI. I dëmuari A.M, me vendbanim në lagjen, rr. “.....” Komuna e Klinës, për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 27.02.2023, ka ngritur aktakuzë nën shenjen PP/II.nr.131/2023, ndaj të pandehurve M.L, H.L, M.G dhe J.G, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Fillimisht, kjo çështje penale më parë ka qenë duke u trajtuar në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Klinë, ndërkaq pasi që gjyqtarja e ngarkuar me këtë lëndë, ka paraqitur kërkesën për përjashtimin e saj nga gjykimi i mëtejme i kësaj çështje penale, e cila është aprovuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, si Autoritet Kompetent përmes aktvendimit GJA.nr.202/24, të dt.04.04.2024, çështja penale P.nr.36/23, i është deleguar Gjykatës Themelore në Pejë në seli. Me çrast, në këtë gjykatë lëndën sipas numrit të dosjes 2023:051927, është pranuar me numër të ri të lëndës P.nr.330/24.

Gjyqtarja e çështjes këtë lëndë e ka pranuar në punë (transfer) në muajin Prill 2024, dhe për këtë çështje penale konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.12.2024, në të cilën seancë prezantuan Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të dëmtuarit A.M si dhe të pandehurve M.L, H.L, M.G dhe J.G.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të pandehurve gjykata i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore konform nenit 241 paragrafi 1 të KPPRK-së, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe pasi që gjykata është bindur së të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, të pandehurve iu është dhënë mundësia që veç e veç të deklarojnë mbi fajësinë apo pafajësinë e tyre, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet,

privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që të njëjtit secili veç e veç dhe me vullnet të plotë e pa kurrfarë presioni kanë deklaruar së pranojnë fajësinë për veprën penale e cila u vihet në barrë, respektivisht që në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, me ç’rast Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*, ku ngjashëm është deklaruar edhe i dëmtuari A.M i cili deklaroi së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*.

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve në raport me dispozitat ligjore të nenit 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së të pandehurve i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të pandehurve dhe pranimi i fajësisë nga ana e tyre po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Shënim Zyrtar M. Sh. #5944 dt.17.01.2023; Raporti i policit S.K.i me dt. 17.01.2023; Deklarata e të dëmtuarit A.M dt. 17.01.2023; Raporti i spitalit i dt. 17.01.2023; Deklarata e të dyshuarit M.L e dhënë pranë Stacionit Policor në Klinë me dt.17.01.2023; Deklarata e të dyshuarit M.G e dhënë pranë Stacionit Policor në Klinë me dt.17.01.2023; Deklarata e të dyshuarit J.G e dhënë pranë Stacionit Policor në Klinë me dt. 17.01.2023; Deklarata e të dyshuarit H.L e dhënë pranë Stacionit Policor në Klinë me dt.17.01.2023; CD; Deklarata e te dëmtuarit ne këtë Prokurori, Deklarata e te pandehurve ne këtë Prokurori*, po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, i propozoi gjykatës: *në kuptim të rrethanave rënduese i propozoj gjykatës që të merr parasysh shkallën e lartë të dashjes të të pandehurve në kuptim të marrjes së viktimës, dërgimit në vendin*

e ngjarjes dhe pas përfundimit të veprës penale, kthimin e tij në vendin ku e kishin marrë, po ashtu i propozoj gjykatës që të marrë parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm ndaj të pandehurve ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

I dëmtuari A.M, ka deklaruar se: dëshiroj të parashtoj kërkesë pasurore juridike, sa i perket të pandehurve M.L dhe H.L nuk kam pasur probleme prej ditës kritike ndërkaq me të pandehurit M.G dhe J.G kam pasur, të njëjtit më kanë ngacmuar prapë, dëshiroj që secili të marr dënimin e tij, nuk kam çka të shtoj tjetër.

I pandehuri M.L, ka deklaruar së: jam penduar për veprën penale që kam kryer me të njëjtin kemi biseduar edhe pas rastit, i kam kërkuar falje, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, i kam dërguar edhe familjarët tek i dëmtuari në mënyrë që të pajtohem.

I pandehuri H.L, ka deklaruar se: fillimisht i kërkoj falje gjykatës për vonesë, i kërkoj falje A. për vepra që kam kryer, jam penduar për veprën të cilën e kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.

I pandehuri M.G, ka deklaruar se: jam penduar për veprën penale që kam kryer, i kërkoj falje Argjendit, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepër të tillë penale.

I pandehuri J.G, ka deklaruar se: jam penduar për veprën penale të cilën kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale, sa i përket deklarimit të të dëmtuarit se unë e kam kërcënuar pas rastit, unë asnjëherë nuk jam takuar me të pas rastit i cili ka ndodhur.

Prandaj me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurve, qëndrojnë të gjitha elementet që në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Sulmi” nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryejnë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që të pandehurit kanë qenë të vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e kanë dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethanat të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, për secilin nga të pandehurit vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin M.L. gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, i ka kërkuar falje të dëmtuarit shprehimisht në seancë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, sjelljen e tij pas konfliktit dhe faktin se nuk kanë pasur konflikte të tjera me viktimën që nga dita e ngjarjes ndërkaq si rrethanë rënduese gjykata mori pikë së pari shkallën e lartë të dashjes dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, prezencën e dhunës në kryerjen e veprës penale si dhe faktin se i pandehuri ka të kaluar kriminale, i njëjti ka qenë i dënuar me dënim me kusht prej gjashtë (6) muajsh për veprën penale *“Sulmi”* nga neni 184 par.1 me Aktgjykim të Formës së Prerë të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, i evidentuar me shenjen P.nr.31/2022, , i plotfuqishëm me dt. 03.01.2024, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej treqind e pesëdhjetë (350) euro për veprën penale *“Lëndim i lehtë trupor”* nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 me Aktgjykim të Formës së Prerë të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, të evidentuar me shenjen P.nr.90/2022, i plotfuqishëm me dt. 12.01.2024, si dhe me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro për veprën penale *“Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, me Aktgjykimin e Formës së Prerë të Gjykatës Themelore në Pejë, të evidentuar me shenjen PKR.nr. 99/2022, i plotfuqishëm me dt. 14.09.2022.

Për të pandehurin H.L., gjykata si rrethana lehtësuese, ka marrë faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, i ka kërkuar falje të dëmtuarit shprehimisht në seancë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, moshën e tij të re në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe faktin se i njëjti nuk është i dënuar me parë, sjelljen e tij pas konfliktit me viktimën dhe faktin se të njëjtit nuk kanë pasur konflikt të tjera që nga dita e ngjarjes, ndërkaq si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh shkallës së lartë të dashjes dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe prezencën e dhunës në kryerjen e veprës penale.

Për të pandehurin M.G, si rrethana lehtësuese gjykata mori parasysh faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, i ka kërkuar falje të dëmtuarit shprehimisht në seancë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, si dhe faktin se i njëjti nuk është i dënuar me parë, ndërkaq si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh shkallën e lartë të dashjes dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe prezencën e dhunës në kryerjen e veprës penale.

Ndërkaq, për të pandehurin J.G, gjykata si rrethana lehtësuese gjeti i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, i ka kërkuar falje të dëmtuarit shprehimisht në seancë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, si dhe faktin se i njëjti nuk është i dënuar me parë, ndërkaq si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh shkallën e lartë të dashjes dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe prezencën e dhunës në kryerjen e veprës penale.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të tyre e që është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Vendimi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për llogaritjen e ndalimit të të pandehurve për dyzetetë (48) orë në dënimin e shqiptuar me gjobë, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 79 par.4 i cili shprehimisht parasheh se “ *Një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim dhe njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni* ” të KRPK-së.

Ndërsa, vendimi si në pikën III dhe IV të dispozitivit për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi nëse të pandehurit dështojnë, refuzojnë apo nuk dëshirojnë që ta paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë është marrë konform nenit 43 par. 3 dhe par. 4 të KRPK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari A.M nga lagjia Arbëria, rr. “Shaban Polluzha”, p.n, në komunën e Klinës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr. 330/24, me datë 20.12.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Leonita Lajqi Muqaj

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e pakënaqur brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa parashtrohet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.